

V E N D I M
Nr.389, datë 12.6.2003

**PËR PËRCAKTIMIN E VJETËRSISË NË PUNË, PËR MARRJEN E TITULLIT TË
PËRKOHSHËM “AUDIT I BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b” të nenit 13 të ligjit nr.9009, datë 13.2.2003 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Specialistët dhe drejtuesit e njësive të kontrollit të brendshëm, që në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr.9009, datë 13.2.2003, janë të punësuar dhe kanë një vjetërsi pune prej 4 vjetësh në këto struktura ose në Kontrollin e Lartë të Shtetit, marrin titullin e përkohshëm “Audit i brendshëm në sektorin publik”, sipas përcaktimeve të shkronjës “b” të nenit 13 të këtij ligji.

2. Vendimi nr.217, datë 5.5.2000 i Këshillit të Ministrave “Për kontrollin financiar”, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Ministri i Financave të nxjerrë udhëzimin përkatës për përcaktimin e procedurave të hollësishme për zbatimin e pikës 1 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano